



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 18 tetor 2010
Ref. nr.: RK 56/10

VENDIM MBI PALEJUESHMËRINË

Për

Rastin nr. 20/09

Petrit Morina

kundër

**Aktgjykimit AP.Nr.495/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës,
të datës 7 prill 2004,**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës Kryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është Z. Petrit Morina nga fshati Polluzhë, Komuna e Rahovecit.

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi sfidon Aktgjykimin AP.Nr.495/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 7 prill 2004.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkon Gjykatës Kushtetuese të marrë parasysh ankesën e tij që, në lidhje me njërën prej veprave, për të cilën është akuzuar për plaçkitje, ai kishte ofruar prova që është i pafajshëm. Ai pretendon që provat e ofruara nuk janë marrë parasysh nga gjykatat.
4. Ai pretendon që e drejta e tij për gjykim të drejtë është shkelur.

Baza ligjore

5. Neni 113 (7) i Kushtetutës, Neni 20 i Ligjit (Nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 16 dhjetor 2008, , (më tutje: «Ligji») si dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tutje: «Rregullorja e Punës»).

Procedura para Gjykatës

6. Më 20 shtator 2009, Parashtruesi ka parashtruar Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Më 28 prill 2010, pas shqyrtimit të Raportit të Gjyqtares Raportuese, Iliriana Islami, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga Gjyqtarët Ivan Cukalovic (Kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu, ia rekomanduan atë Gjykatës së plotë në lidhje me papranushmërinë e Kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

7. Nga parashtruesit mund të kuptohet që me aktgjykimin P.Nr.236/02 të datës 31 mars 2003, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka dënuar Parashtruesin, bashkë me disa persona tjerë të akuzuar, për nëntë pika aktakuze të plaçkitjes dhe plaçkitjes së rënduar, si dhe e ka dënuar atë me 12 vjet burgim, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim qysh prej 5 gushtit 2002.
8. Parashtruesi është ankuar ndaj aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme në bazat e «shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale, vlerësim të gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve dhe shkeljes së ligjit penal», duke i propozuar Gjykatës Supreme që të rrëzojë aktgjykimin e atakuar dhe ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, apo ta ndryshojë verdiktin në mënyrën siç është kërkuar nga avokati i mbrojtjes. Ai ka parashtruar gjithashtu një ankesë speciale në baza të ngjashme.
9. Me parashtruesin PPA.Nr.494/2003 të datës 22 dhjetor 2003, Prokurori Publik i propozoi Gjykatës Supreme që ta refuzojë ankesën si të pabazuar.
10. Më 7 prill 2004, Gjykata Supreme vendosi që ankesa e Parashtruesit ishte pjesërisht e bazuar, si dhe ri-kualifikoi disa vepra penale për të cilat ishte dënuar Parashtruesi, nga «kryerja e plaçkitjes në grup» në «kryerje të vjedhjes».

Pretendimet e Parashtruesit

11. Parashtruesi pretendon që Gjykata e Qarkut në Prishtinë e ka dënuar atë gabimisht për një pikë të vjedhjes, për të cilën ai ka marrë dënimin me 30 muaj, sepse ajo vjedhje ishte kryer nga dy të bashkë-akuzuarit dhe dy vëllezërit e njërit prej tyre. Pretendimi i tij duket të jetë i mbështetur nga një deklaratë me shkrim e njërit nga të

bashkë-akuzuarit, në të cilën ky i fundit ka deklaruar që Parashtruesi nuk ka marrë pjesë në këtë vjedhje.

12. Parashtruesi ankohet që duhet të vuajë burgimin për 30 muaj për një vepër që nuk e ka kryer, pasi që Prokurori i Qarkut dhe organet tjera gjyqësore kanë refuzuar të rihapin rastin për të zbuluar të vërtetën.

Vlerësimi i lejueshmërisë së Kërkesës

13. Për të qenë në gjendje të gjykojë Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse Parashtruesi ka plotësuar kërkesat e lejueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Ligj.
14. Në lidhje me Kërkesën në fjalë, Gjykata Kushtetuese thekson që Parashtruesi ankohet për vendimin Ap.Nr.495/2003 nga Gjykata Supreme, i cili ka datën 7 prill 2004. Kjo do të thotë që Kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, e cila është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, kërkesa është e pasafatshme, dhe si e tillë, në mospërputhje *ratione temporis* me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Litanisė, Kėrkesa nr. 41510/98, Aktgjykimet e GjEDNj-sė të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003*).
15. Rrjedhimisht, Kërkesa e Parashtruesit duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit, dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëlëzi:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ Kërkesën si të papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'iu komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Dr. Iliriana Islami



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani